



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



**NJOFTIM PARAPRAK
për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial**

Njoftojmë subjektet afariste të komunës, ato të vendit dhe të huaja se në ditët në vijim pritet të shpallet konkursi publik për vendosje në Zonën ekonomike – Parkun Industrial në fshatin Lumadh të Komunës së vushtrrisë.

Numri i parcelave të lira: sipas skicës së Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Madhësia e parcelave: varësisht nga kërkesat e subjekteve afariste,

Veprimtaritë e lejuara në parkun industrial: Në parkun industrial mund të zhvillohet çdo veprimtari afariste e cila nuk cenon rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin, florën dhe faunën dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Përparësitë për vendosje në parkun industrial: Me rastin e shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë ato biznese të cilat merren me veprimtari prodhuese, përpunimit të produkteve si dhe ato të cilat rrisin numrin e punëtorëve në raport me numrin ekzistues të biznesit.

E drejta e aplikimit: Të drejtë aplikimi kanë të gjitha bizneset vendore dhe të huaja të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret që janë të përcaktuara në konkurs, që kanë për qëllim zhvillimin dhe zgjerimin e kapaciteteve biznesore dhe rritjen e zhvillimit ekonomik.

Afati i dhënies në shfrytëzim – deri në 99 vite nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës